



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

PRISHTINË, 03 MARS 2011  
NR. REF.:AGJ/85/11.

**AKTGJYKIM**

në

**Rastin nr. KI 32/10**

**Fahrudin Megjedovic, Zëvendëskryesues për Komunitete i Kuvendit Komunal të Pejës**

**kundër**

**Vendimit të Kuvendit Komunal të Pejës për emërimin e Nënkrjetarit të Komunës për Komunitete të datës 15 shkurt 2010**

**GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Në përbërje të:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

**Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Fahrudin Megjedovic, Zëvendëskryesues për Komunitete i Kuvendit Komunal të Pejës.

**Vendimi i sfiduar**

2. Parashtruesi i kërkesës sfidon vendimin e Kuvendit Komunal të Pejës për emërimin e Nënkrjetarit të Komunës për Komunitete të datës 15 shkurt 2010.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kërkesës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: "Gjykata") më 17 maj 2010 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Kuvendit Komunal të Pejës për emërimin e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete të datës 15 shkurt 2010.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa e parashtruesit bazohet në nenin 62.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: "Kushtetuta"), nenin 55.4 të Ligjit Nr. 03/LO40 për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: "Ligji"), Rregullin 29 të Rregullorës së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: "Rregullorja e Punës").

## **Procedura para Gjykatës**

5. Më 17 maj 2010 Zëvendëskryesuesi për Komunitete i Kuvendit Komunal të Pejës (në tekstin e mëtejshëm: KK Pejë) parashtrroi një kërkesë në Gjykatë me të cilën kërkonte të bëhej vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Kuvendit Komunal të datës 15 shkurt 2010 në lidhje me zgjedhjen e Nënkyetarit për Komunitete të Komunës së Pejës.
6. Më 2 korrik 2010, kryetari i Gjykatës në pajtim me Rregulloren e Punës e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues dhe kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarit Robert Carolan (kryesues), dhe gjyqtarëve Altay Suroy dhe Snezhana Botusharova.
7. Më 5 korrik 2010 Sekretariati i Gjykatës e njoftoi Komunën e Pejës për kërkesën dhe kërkoi nga ajo përgjigjen e saj. Me keqardhje Gjykata bën me dije se Komuna e Pejës nuk ofroi asnjë përgjigje në atë kërkesë.
8. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Gjykata në përbërje të plotë mbajti këshillim në lidhje me kërkesën në një seancë të mbyllur.

## **Përmbledhje e fakteve**

9. Më 15 janar 2010, Kuvendi Komunal i Pejës mbajti seancën përruese pas zgjedhjeve lokale të 15 nëntorit 2009. Pika e 6-të e rendit të ditës ishte propozimi për emërimin e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete.
10. Procesverbali zbulon se "me propozimin e kryetarit të komunës Dr. Ali Berisha, në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi dhe pas konsultimeve në nivelin më të lartë institucional, të emëruarit për Nënkyetar dhe Nënkyetarë për komunitete" ishin:
  1. Z. Gazmend Muhaxheri, Nënkyetar i Komunës;
  2. Z. Ibish Bajrami, Nënkyetar i Komunës për Komunitete; dhe
  3. Z. Drenko Todorovic, Nënkyetar i Komunës për Komunitetin serb.
11. Z. Fahrudin Megjedovic, i cili është anëtar i kuvendit komunal nga komuniteti boshnjak dhe njëherit Zëvendëskryesues i Kuvendit Komunal për Komunitete në Pejë, e kontestoi emërimin pasi që konsideronte se vendimi është i paligjshëm. Reagimi i tij u publikua në mediet e shtypura dhe elektronike.
12. Në seancën e radhës të Kuvendit Komunal të mbajtur më 15 shkurt 2010, pika e 7-të (shtatë) e rendit të ditës ishte përsëritja e votimit për pozitën e Nënkyetarit të Komunës

për Komunitete edhe pse në procesverbal shkruante se z. Ibish Bajrami tashmë ishte emëruar në atë pozitë më 15 janar 2010. Në këtë seancë Kryetari i Komunës përsëri e propozoi z. Ibish Bajramin për pozitën e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete.

13. Propozimin e paraqitur nga Kryetari i Komunës e vuri në votim Kryesuesi i Kuvendit, dhe, nga 40 anëtarë të pranishëm të Kuvendit Komunal, 38 votuan për dhe 2 kundër propozimit. Votat e anëtarëve të Kuvendit nga radhët e komuniteteve ishte të ndara në dysh: dy ishin për dhe dy ishin kundër propozimit të kryetarit të komunës. Në ngjarjet që pasuan Kryesuesi i Kuvendit bëri me dije se po jepte votën vendimtare për z. Ibish Bajramin dhe e shpalli atë të zgjedhur në mënyrë të rregullt.
14. Më 19 shkurt 2010, parashtruesi në cilësinë e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit Komunal për Komunitete parashtrroi ankesë pranë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (në tekstin e mëtejme: "MAPL") në të cilën përshkruan procedurën e ndjekur për zgjedhjen e z. Ibish Bajramit në pozitën e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete në komunën e Pejës. Ai kërkoi nga MAPL të nxirrte një vendim që do të anulonte vendimin e KK të Pejës të datës 15 shkurt 2010 dhe të detyronte KK-në e Pejës që ta përsërisë procesin e votimit për zgjedhjen e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete. Në ngjarjet që pasuan MAPL nuk e anuloi vendimin e KK-së së Pejës.
15. Më 13 prill 2010, parashtruesi i kërkesës i paraqiti një kërkesë Kryetarit të Komunës, me të cilën kërkoi që në seancën e ardhshme të Komitetit për Politika dhe Financa, dhe në seancën e ardhshme të Kuvendit Komunal, në rendin e ditës duhet të përfshihet edhe çështja e zgjedhjes së Nënkryetarit të Komunës për Komunitete.
16. Çështja nuk u fut në rendin e ditës së mbledhjes së ardhshme të Kuvendit Komunal.
17. Me një letër të datës 21 shkurt 2010 MAPL e njoftoi Komunën e Pejës se, në bazë të raportit të vëzhguesve të saj të pranishëm në seancën e datës 15 shkurt 2010 të KK të Pejës, kishte ardhur në përfundim se zgjedhja e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete nuk ishte bërë në kundërshtim me nenin 61.3 të Ligjit për Vetë-Qeverisjen Lokale. MAPL e urdhëroi KK e Pejës të rishikojë vendimin në fjalë brenda afatit të paraparë me nenin 82.2 të Ligjit për Vetë-Qeverisjen Lokale.
18. Më 11 mars 2010 Komuna e Pejës i dërgoi MAPL-së përgjigjen e saj me shkrim në të cilën theksonte se Vendimi i Kuvendit Komunal për zgjedhjen e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete i datës 15 shkurt 2010 ka qenë i ligjshëm dhe i rregullt dhe kësaj KK e Pejës konsideron se nuk ka arsye për ta pezulluar apo rishikuar atë.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Vendimi i Kuvendit Komunal në Pejë i ka shkelur të drejtat kushtetuese për mjete efektive juridike si dhe të drejtën për t'u zgjedhur. Sipas parashtruesit zgjedhja e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete nga ana e Kuvendit Komunal është bërë në kundërshtim me nenin 61.3 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së vendimit në fjalë.
20. Në esencë parashtruesi i kërkesës është i mendimit se Kryesuesi nuk ka pasur të drejtë të jipte votë vendimtare për z. Bajramin kur anëtarët nga radhët e komuniteteve ishin të ndarë me numër të barabartë të votave për dhe kundër propozimit. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës konsideron se emërimi i z. Bajramit ishte i paligjshëm dhe në kundërshtim me të drejtat kushtetuese për pjesëtarët e komuniteteve.

## **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

21. Neni 82 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ka të bëjë me procedurat për shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve të Komunave në Kosovë. Ky nen i jep të drejtën e diskrecionit Ministrisë të Vetëqeverisjes Lokale për të ngritur çështjen e ligjshmërisë apo kushtetutshmërisë së vendimeve apo akteve të Komunave pranë Gjykatës së Qarkut. Neni parasheh si në vijim:

### ***Neni 82 Procedura për shqyrtimin e ligjshmërisë***

*82.1 Nëse autoriteti mbikëqyrës konsideron se një vendim apo një akt i komunës nuk është në përputhje me kushtetutën dhe ligjet, ai mund të kërkojë që komuna ta rishqyrtojë vendimin apo aktin e tillë. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet e supozuara të shkeljes së kushtetutës apo ligjit dhe nuk suspendon ekzekutimin e vendimit komunal apo akteve të tjera.*

*82.2 Organi i njësisë së vetëqeverisjes lokale i përgjigjet kërkesës për rishqyrtim, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës.*

*82.3 Nëse komuna pranon kërkesën për rishqyrtim, ajo mund të suspendojë ekzekutimin e vendimit të kontestuar apo aktit deri në shqyrtimin e saj nga autoritetet lokale.*

*82.4 Nëse komuna nuk përgjigjet brenda afatit apo refuzon kërkesën, apo mbështet vendimin apo aktin e kontestuar, autoriteti mbikëqyrës mund ta kundërshtojë aktin në fjalë në Gjykatën e Qarkut që është kompetent për territorin e komunës, brenda 30 ditësh pas dështimit për t'iu përgjigjur njoftimit për refuzimin apo mbështetjen e vendimit apo aktit të kontestuar.*

*82.5 Gjykata e Qarkut mund të urdhërojë, si masë të përkohshme, suspendimin e zbatimit të vendimit apo aktit të kontestuar apo akteve të tjera të përkohshme në pajtim me ligjin në zbatim.*

22. Kjo fuqi e referimit të çështjes në Gjykatën e Qarkut është vetëm diskrecionale. Ajo nuk është ushtruar nga ministri përkatës. Pasi që ministri nuk e ka ushtruar këtë fuqi diskrecionale nuk ka pasur në dispozicion rrugë tjetër të ankimit kundër vendimit të KK të Pejës të datës 15 shkurt përpos referimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese.
23. Sipas nenit 113 (1) të Kushtetutës Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura në mënyrë ligjore nga palët e autorizuar. Z. Megjedovic e paraqet këtë kërkesë si Zëvendëskryesues për komunitete i një komune dhe si i tillë ai është palë e autorizuar për të referuar në Gjykatën Kushtetuese akte apo vendime të komunës që pretendohet se janë në kundërshtim me të drejtat e tij.
24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet dispozitave të nenit 62.3 dhe 62.4 të Kushtetutës në lidhje me përfaqësimin në institucionet e qeverisjes lokale i cili parasheh si në vijim:

### ***Neni 62.3***

*Zëvendëskryetari për komunitetet, do të promovojë dialog ndërmjet komuniteteve dhe shërben si pikë formale e kontaktit për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve që nuk janë shumicë në takimet e kuvendit të komunës dhe në punët e saj. Zëvendëskryetari gjithashtu është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave që parashtrihen nga komunitetet ose pjesëtarët e tyre, nëse aktet a vendimet e kuvendit të komunës shkelin të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë. Zëvendëskryetari këto çështje i'a referon kuvendit të komunës, për rishqyrtimin e aktit a të vendimit të marrë.*

## **Neni 62.4**

*Në rast se kuvendi i komunës vendos që të mos rishqyrtojë aktin a vendimin e vet, ose nëse zëvendëskryetari vlerëson se, edhe pas rishqyrtimit rezultati përbën shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ai/ajo mund të parashtrojë çështjen drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, e cila mund të vendosë nëse do të pranojë ta shqyrtojë rastin përkatës.*

25. Në kërkesë pretendohet për një shkelje të të drejtave të garantuara me kushtetutë dhe ajo është paraqitur nga një person i autorizuar. Gjykata është e kënaqur që parashtruesi i kërkesës e ka statusin e duhur ligjor dhe autoritetin për të paraqitur këtë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese dhe që kërkesa si e tillë është e pranueshme.

## **Meritat**

26. Të sjellim ndërmend pra se parashtruesi i kërkesës e sfidon vendimin e Kuvendit Komunal të Pejës për emërimin e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete të datës 15 shkurt 2010. Nga faktet e parashtruara është e qartë se ankesa e parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me të drejtat dhe mbrojtjen e veçantë që u jepet personave të komunitetet jo-shumicë në Republikën e Kosovës. Një pozitë e tillë e veçantë e komuniteteve jo-shumicë reflektohet posaçërisht në përfaqësimin e garantuar, në rrethana të caktuara në komuna dhe në Kuvendin e Kosovës.
27. Kjo pozitë në ligj fillimisht rrjedh nga dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës, që zakonisht referohet si plani i Ahtisaarit. Në të vërtetë, një fushë që i është dhënë vëmendje e veçantë është ajo që ka të bëjë me të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre siç parashihet në nenin 3 të Propozimit Gjithëpërfshirës:

### ***Neni 3 Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre***

*3.1 Banorët që i përkasin të njëjtit grup kombëtar apo etnik, gjuhësor, apo grupi fetar tradicionalisht prezent në territorin e Kosovës (më tej Komunitete) do të kenë të drejta të veçanta, të përcaktuara në Aneksin II të kësaj Marrëveshjeje, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të përcaktuara në Nenin 2 të Aneksit I të kësaj Marrëveshjeje.*

*3.2 Kosova do të garantojë mbrojtjen e identitetit kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Kosova do të krijojë mekanizma kushtetues, ligjorë dhe institucionalë të nevojshëm për promovimin dhe mbrojtjen e drejtave të të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve dhe për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e tyre efektive në proceset politike dhe vendimmarrëse, siç përcaktohet me Aneksin I dhe II të kësaj Marrëveshjeje.*

28. Aneksin e referuara në nenin 3 të Propozimit Gjithëpërfshirës kanë të bëjnë me mbrojtjen substanciale që u jepet komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.
29. Kushtetuta gjithashtu e ka një kapitull të veçantë në lidhje me të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Kapitulli III i Kushtetutës në nenet 57 deri 62 në thelb reflekton si dhe përforcon obligimet dhe të drejtat që i përmban Propozimi Gjithëpërfshirës. Neni 57 që ka të bëjë me parimet e përgjithshme për të drejtat e komuniteteve parasheh si në vijim:



### **Neni 57 [Parimet e përgjithshme]**

1. Banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet), gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute.
2. Çdo pjesëtar i komunitetit do të ketë të drejtën që të zgjedhë lirisht nëse do të trajtohet ose të mos trajtohet si pjesëtar i komunitetit dhe nga kjo zgjedhje ose nga ushtrimi i të drejtave që ndërlidhen me këtë zgjedhje, nuk do të rezultojë asnjë diskriminim.
3. Pjesëtarët e komuniteteve do të kenë të drejtë që të shprehin, të avancojnë dhe të zhvillojnë lirisht identitetin dhe atributet e tyre si komunitet.
4. Ushtrimi i këtyre të drejtave do të bartë me vete detyrimet dhe përgjegjësitë për të vepruar në pajtim me ligjin e Republikës së Kosovës, dhe nuk i cenon të drejtat e tjerëve.

30. Kjo Gjykatë kishte tërhequr vëmendjen në mbrojtjet kushtetuese dhe ligjore që u jepen komuniteteve në aktgjykimin e vet në rastin e Cemail Kurtesi kundër Komunës së Prizrenit, KO 01/09 të datës 18 mars 2010. Kjo Gjykatë i referohet tani atij aktgjykimi si dhe paraqitjes së natyrës së institucioneve të Vetëqeverisjes lokale dhe obligimeve të tyre në raport me të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre (shih, paragrafët 17, 30, 31, 32, 35, 36, dhe 38 të aktgjykimit në fjalë).
31. Thelbi i kërkesës që është objekt shqyrtimi i Gjykatës ka të bëjë me atë se a ishte propozimi, zgjedhja dhe emërimi i Nënkrjetarit të Komunës së Pejës për Komunitete kushtetuese dhe nëse rrethanat që shoqëruan zgjedhjen dhe emërimin e tij kishin shkelur ndonjë dispozitë kushtetuese. Prandaj t'i kthehemi dispozitave specifike ligjore që vlejné për zgjedhjen e Nënkrjetarit të Komunës.
32. Neni 61 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji nr. 03/L-040 i datës 20 shkurt 2008 parasheh propozimin, zgjedhjen si dhe detyrat e Nënkrjetarit të Komunës për Komunitete në komunat ku të paktën dhjetë përqind (10%) e qytetarëve u përkasin komuniteteve që nuk janë shumicë në ato komuna. Ky nen parasheh:

#### **Neni 61 Nënkrjetari i Komunës për Komunitete**

- 61.1 Komunitetet ku të paktën 10% e qytetarëve i përkasin komuniteteve jo-shumicë do të kenë një nënkryetar për komunitete.
- 61.2 Nënkrjetari për Komunitete do të emërohet për mandat të njëjtë si të kryetari.
- 61.3 Emërimi dhe shkarkimi i Nënkrjetarit për Komuniteteve propozohet nga Kryetari i Komunës dhe duhet të miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë si dhe shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë të cilët i përkasin komuniteteve joshumicë.
- 61.4 Nënkrjetari për komunitete do t'i ndihmojë kryetarin dhe do të ofrojë këshilla dhe udhëzime për kryetarin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin pakicë.
- 61.5 Kur posti i nënkryetarit për komunitete mbetet i lirë, kryetari propozon nënkryetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë sipas procedureave të paragrafit 3 të këtij neni.
- 61.6 Neni 59 i këtij ligji për konfliktet e interesit të kryetarit zbatohet mutatis mutandis për nënkryetarin për komunitete.

33. Mekanizmi ligjor parasheh të ndodhin tri veprime për zgjedhjen e tij/saj. Veprimi i parë është që Nënkrjetari i Komunës për Komunitete të propozohet nga Kryetari i Komunës.

Veprimi i dytë është që shumica e anëtarëve të Kuvendit Komunal të votojë për personin e propozuar. Veprimi i tretë është që shumica e anëtarëve të Kuvendit Komunal nga radhët e komuniteteve jo-shumicë që janë të pranishëm dhe votojnë po ashtu duhet të votojnë për të.

34. Sipas procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit Komunal e datës 15 shkurt 2010 dy veprimet e para kanë ndodhur. Z. Bajrami u propozua nga Kryetari i Komunës dhe mori shumicën dërrmuese të anëtarëve të Kuvendit Komunal që ishin pranishëm dhe që kishin votuar. Mirëpo ai nuk mori shumicën e votave nga anëtarët që u përkasin komuniteteve jo-shumicë. Votat e tyre ishin të barabarta: dy votuan për z. Bajramin kurse dy kundër tij.
35. Tani t'i kthehemi pra dispozitave të nenit 48 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale që ka të bëjë me votimin në Kuvendin Komunal. Ai parasheh:

#### **Neni 48 Votimi**

*48.1 Në të gjitha takimet e kuvendit të komunës dhe komitetet e tij, çdo person, përfshirë edhe kryesuesin, ka nga një votë, por kryesuesi ka një votë shtesë nëse votimi është i barabartë për ose kundër një propozimi.*

*48.2 Nëse ndryshe nuk parashihet shprehimisht në këtë ligj, vendimet e kuvendit të komunës aprovohen me shumicën e anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë.*

*48.3 Abstenimet regjistrohen me qëllim të themelimit të kuorumit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit.*

36. Zakonisht, në rast të votimit të barabartë, një ngjarje që ka gjasa të ndodh me kalimin e kohës, shumë kuvende, legjislatura dhe parlamente parashohin që një person të ketë votë vendimtare me qëllim të shmangies së situatave të bllokimit dhe të mundësimit të kryerjes së punës. Në rastin e komunave të Kosovës kjo votë vendimtare, sipas dispozitave të nenit 48.1 të cituar më lart, i jepet Kryesuesit të Kuvendit. Për shkak se gjatë zgjedhjes e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete kishte numër të barabartë të votave, Kryesuesi i Kuvendit Komunal vendosi në të mirë të z. Bajramit dhe rrjedhimisht ai u shpall i zgjedhur.
37. Çështja thelbësore është se a kishte Kryesuesi i Kuvendit Komunal fuqinë për të dhënë votën vendimtare në ato rrethana. Formulimi i nenit 48.1 i referohet “të gjitha takimeve të Kuvendit Komunal dhe të komiteteve të tij”. Sigurisht zgjedhja nga ana e anëtarëve nga radhët e komuniteteve jo-shumicë nuk ishte takim i një komiteti të kuvendit. Askund në legjislacion nuk parashihet që kjo punë ishte punë e “komitetit”.
38. Prandaj, a ishte zgjedhja e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete nga ana e anëtarëve të komunitetit jo-shumicë, veprimi i tretë që u përmend më lart, “takim i Kuvendit Komunal” në rrethanat kur Kuvendi tashmë e kishte miratuar zgjedhjen e tij me shumicë dërrmuese? Gjykata konstaton se nuk ishte. Votimi në atë fazë nuk ishte votim i Kuvendit Komunal në përbërje të plotë. Në të vërtetë ky ishte votim i një pjese të Kuvendit. Një pjesë që nuk parashikohet në nenin 48.1 dhe as në rregullat dhe mbrojtjet e veçanta që vlejné për atë votim, dhe nuk kishte asnjë dispozitë për shfrytëzimin e votës vendimtare në rast të numrit të barabartë të votave në ato rrethana.
39. Për shkak të mbrojtjeve të veçanta që i gëzojnë komunitetet dhe pjesëtarët e tyre me kushtetutë dhe me ligj, kjo Gjykatë vjen në përfundim se është bërë një ndërhyrje në të drejtat specifike të komuniteteve me intervenimin e Kryesuesit kur votimi ishte ndarë në numër të barabartë votash. Ai nuk ka pasur të drejtë të përdorte votën vendimtare për të zgjidhur atë situatë konkrete të bllokimit. Anëtarët e Kuvendit Komunal nga radhët e komuniteteve jo-shumicë ishin të vetmit ata që mund ta merrnin atë vendim për vetveten dhe ligji e kërkonte që ata ta bënin këtë me shumicë votash.

40. Gjykata është e mendimit se pjesëmarrja në votim, dhe shfrytëzimi i votës vendimtare nga ana e Kryesuesit ka shkaktuar ndikim të drejtpërdrejtë në vendimin për zgjedhjen e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete që ka shkelur të drejtat e komuniteteve tjera duke mos e respektuar vullnetin e tyre pasi që në kuvend votat e anëtarëve të kuvendit nga radhët e komuniteteve ishin të barabarta: 2 vota për dhe 2 vota kundër propozimit të Kryetarit të Komunës.
41. Prandaj të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 45 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 57 të Kushtetutës janë shkelur me zgjedhjen e z. Bajramit Nënkyetar të Komunës të Pejës për Komunitete me anë të votës vendimtare të Kryesuesit të Kuvendit Komunal.

**PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NJËZËRI VENDOS si në vijim:**

- I. SHPALL kërkesën të pranueshme;
- II. KONSTATON se ka shkelje të nenit 45 dhe 54 në lidhje me nenin 57 të Kushtetutës së Kosovës me zgjedhjen e z. Ibish Bajramit Nënkyetar për Komunitete të Komunës së Pejës me anë të votës vendimtare të Kryesuesit të Kuvendit Komunal;
- III. SHPALL të pavlefshme zgjedhjen e Nënkyetarit për Komunitete të Komunës së Pejës të mbajtur më 15 shkurt 2010;
- IV. URDHËRON Kuvendin Komunal të iniciojë përsëritje të zgjedhjes së Nënkyetarit të Komunës për Komunitete, në përputhje me këtë aktgjykim;
- V. KËRKON nga Kuvendi Komunal t'i raportojë Gjykatës për hapat që ka ndërmarrë për t'iu bindur këtij aktgjykimi në afat prej tre muajsh nga data e botimit të tij;
- VI. Në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ky aktgjykim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare;
- VII. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë dhe mund të jetë objekt i rishikimit redaktorial.

Gjyqtari raportues

Mr.sc.Kadri Kryeziu



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani